



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Nr. 12/1

Tiranë më 27.05.2009

L I C E N C Ë
Nr. 12 datë 15.03.1999

PËR TË VEPRUAR SI BANKË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 7, 10 dhe 11 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 3, pika 4 shkronja "c", nenit 12 dhe nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", vendimit nr.22, datë 03.03.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, "BANKËS PROCREDIT" sh.a. me drejtori qendrore në Tiranë (ish Banka Fefad sh.a.), ndryshuar emri nëpërmjet aktit zyrtar nr. 2516/1, datë 08.09.2003 të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, i jepet licenca për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon "BANKËS PROCREDIT" sh.a. të kryejë veprimtari të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

Ardian FULLANI
GUVERNATOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES



Nr. 6748 Prot.

Tiranë, më 19.9.2022

Lënda: Aneksi i ri i licencës

BANKËS PROCREDIT SH.A.

Tiranë

Z. Mirsad Haliti

Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive

I nderuar z. Drejtor,

Në zbatim të pikës 1, neni 99 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”, bashkëlidhur do të gjeni aneksin e përditësuar për veprimtaritë bankare dhe financiare të lejueshme për t’u kryer nga Banka Procredit sh.a.

DREJTOR

Deniz Deralla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

ProCredit Bank sh.a
Sekretaria

21-09-2022

Nr. _____ prot. _____

Tiranë më 29.8.2022

ANEKS

LICENCA NR. 12/1

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR BANKËN PROCREDIT SH.A.

Banka Procredit sh.a., në bazë të nenit 134, pika 1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 11.02.2009 “Për përshtatjen e dokumentacionit mbi të cilin mbështetet veprimtaria bankare dhe financiare e bankave, që operojnë në Republikën e Shqipërisë me kërkesat e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 68, datë 18.12.2014 “Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka ProCredit sh.a.”, dhe të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”, është e licencuar të kryejë veprimtaritë bankare sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe veprimtaritë financiare si më poshtë:

- 1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore;
- 2) Qiranë financiare;
- 3) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave¹;
- 4) Ofrimin e garancive;
- 5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i) instrumente të tregut të parase (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.),
 - ii) këmbim valutor,

¹ Në bazë të nenit 99, pika 1 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”, veprimtaria “Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave” është e përditësuar sipas Aneksit 1 të këtij ligji duke shtuar pikën 10 në këtë Aneks.

- iii) instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen;
- 6) Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit;
- 7) Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj.², përfshirë emetimin e parasë elektronike;
- 8) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në pikat 2 deri 7 si më sipër;
- 9) Tregtimin për llogari të saj, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme;
- 10) Shërbimet e pagesave, të listuara nga pika 1 deri në pikën 8 të Aneksit 1 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”, si vijon:
- 10.1) Shërbimet që mundësojnë depozitim të parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
- 10.2) Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
- 10.3) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
- a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
- b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
- c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
- 10.4) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
- a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
- b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
- c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.

² Veprimtaria “Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj.” është e parashikuar dhe në Aneksin 1 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”. Për shkak të parashikimit të këtyre veprimtarive në ligje të ndryshme dhe me qëllim pasqyrimin e historikut të veprimtarive, këto veprimtari do të vazhdojnë të jenë të pasqyruara të dyja në Aneksin e Licencës.

- 10.5) Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave,
- 10.6) Dërgesat e parave,
- 10.7) Shërbimi i inicimit të pagesës,
- 10.8) Shërbimi i informimit të llogarisë.

GUVERNATOR

Gent Sejko

